



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK KORÇË

VENDIM

Nr. 66 datë 26-06-2025

PËR MIRATIMIN E PLAN BIZNESIT PËR VITIN 2025 TË SHA TREGU I SHITJES ME SHUMICË FRUTA – PERIME KORÇË, TË MBLEDHJES SË DATËS 26-QERSHOR TË KESHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me Këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe Plan Biznesin për vitin 2025 të njoftuara për vendimmarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 24.06.2025, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 5 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 97, pika 2 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë të miratuar me VKM nr. 80, datë 30.07.2020

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë Plan Biznesin për vitin 2025 të SHA Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime Korçë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 17 Vota

Vota Pro 17

Vota Kundër 3

Vota Abstenim 1

Zbardhur në datë 27-06-2025



KRYETAR

Ana VERUSHI